



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i procesverbalit i Dëgjimit publik, Personeli shëndetësor QKMF, QMF, i Komunës së Prishtinës, mbajtur më 12.7.2023, duke filluar nga ora 14:00.

Në mbledhje morën pjesë: Osman Bllaca - kryesues, Valbona Makolli- drejtore e Drejtorisë së Financave, Izet Sadiku- drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Lulzim Fushtica- drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, Mimoza Sylejmani- drejtore e Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, drejtorja e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale Adelina Sahiti, dhe zyrtari Rrahman Qerimi nga Drejtoria e Investimeve Kapitale.

Të pranishëm ishin edhe: Besim Murseli, Drilon Morina, Agnesa Sahiti, Hana Deshishku, Zelfije Visoka, Teuta Rugova, Venera Maxhuni, Besa Canhasi, Violeta Haxhijaj, Fitnete Statovci, Ali Dërguti, Shpresa Krasniqi, Vjollca Zeqiri, Mirdita Hajdari, Erëza Qorri, Liridona Gashnjani, Leart Sadiku, Zijavere Mexhuani, Dardan Brahimi, Adriana Makolli, Leona Jashari, Kimete Jashari, Shyqrie Mehmeti, Rrezart Halili, Florie Hyseni.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Osman Bllaca**, kryesues.

Osman Bllaca, kryesues falënderoi të pranishmit duke hapur takimin që ka të bëjë me dëgjimin buxhetor me kërkesat dhe nevojat e personelit mjekësor të Kryeqytetit, të cilat do të përfshihen në buxhetin për vitin 2024.

Valbona Makolli, drejtore falënderoi pjesëmarrësit e pranishëm në dëgjim lidhur me buxhetin për vitin 2024. Ajo tha se kanë pranuar Qarkoren e parë buxhetore nga Ministria e Financave, ku Kryeqytetit për vitin 2024, do t'i takojnë **122 milionë, 790.872 mijë euro**. Nga ky grant specifik për shëndetësinë, për vitin 2024, janë paraparë **10 milionë e 456 mijë e 520 mijë euro**.

Rrezart Halili, zëvendësdrejtor në QKMF Prishtinë pyeti drejtoren, pasi që vitin e kaluar është diskutuar procesi i kontraktimit të shërbimeve private për vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë dhe kujdesin paliativ, dhe i intereson të dijë se a ka lëvizje këtë vit apo vitin tjetër në atë drejtim sepse fondet veç janë të ndara prej Ministrisë së Shëndetësisë.

Izet Sadiki, drejtor: tha se në buxhetin e ardhshëm që jemi duke planifikuar për investime kapitale, si drejtori kemi diku rreth 250 % më shumë planifikime për rritje buxheti për shëndetësi, për investime kapitale, ku faktikisht vitin e ardhshëm njëra prej shtyllave kryesore të investimit në shëndetësi do të jetë Spitali i Qytetit, të cilin ne mendojmë që do të fillojmë këtë vit dhe realisht 5 milionë janë ndarë vitin e ardhshëm për ndërtimin e tij, janë të propozuara e pastaj do të kalojnë në asamble, e sigurisht që edhe në të gjitha fushat tjera, sidomos te renovimet, te pajisjet mjekësore është rritur buxheti. Ai dha sqarim se tek këto projekte është e vërtetë që ne e kemi fondin për to, i cili është 550 mijë euro dhe e kemi diskutuar disa herë dhe jemi duke e diskutuar me UNICEF-in dhe me Ministrinë e Shëndetësisë, për arsye se ne e dimë se ky është një projekt shumë i rëndësishëm për qytetarët e Prishtinës, por që është shumë sfidues për punëtorët shëndetësorë, për arsye se ky projekt do shumë më shumë staf se që ne kemi kapacitete brenda. Ai tha se projekti ka filluar me qëllim që me marrë staf të ri dhe realisht ka pas dilema se me këto mjete që janë të parapara a mund të blihen shërbime, për arsye se paratë po mbesin, ndërsa ne realisht nuk jemi duke dhënë shërbimin që ne presim për atë. Ka kërkesa të mëdha për atë shërbim, pra për vizitat sistematike të grave shtatzëna dhe fëmijëve prej 0-3 vjeç, që parashihet të jenë 3 vizita dhe kur të bëhet komplet programi ndodh që Prishtina të ketë 30 mijë vizita vjetore dhe për t'i bërë këto 30 mijë vizita duhet të ketë staf shumë më të madh 30-40 veta që merren veç me këtë punë.

Bujar Gashi, drejtor i QKMF-së Prishtinë, kërkoi prej drejtores me mbajt shënim se vitin e kaluar ose këtë vit kemi pasur problem për një çështje të caktuar për çështjen e parave të imta, apo peti keshit, që nuk është problem i komunës, por është problem qendror dhe është një çështje që vështirë tejkalohet dhe vështirë menaxhohet pa pasur peti - kesh. Ai tha se duke marrë parasysh që i kemi 33 institucione dhe ka nevoja të përditshme dhe kishte me qenë mirë që të iniciohet, së paku të kemi një shumë vjetore andaj e kemi planifikuar në buxhet, dhe planifikimi jonë buxhetor besoj që javën e ardhshme do të dërgohet dhe atë që e kemi planifikuar na që do ta keni si bazë si brumë të planifikimit buxhetor edhe në mallra shërbime edhe në investime kapitale dhe normalisht nga Drejtoria e Shëndetësisë, do të këtë por në planifikimin e mallrave dhe shërbimeve. Ai tha se vitin e kaluar ka qenë problem se nuk mundet me u ndarë në 12 muaj, duhet me qenë vetëm një, por së paku shuma të jetë deri në 5 mijë euro, që të kemi mundësi së paku disa detaje të vogla t'i mbulojmë.

Valbona Makolli, drejtore tha se peti-keshi, kuptohet që është për krejt komunën një nivel i caktuar, mirëpo ajo nuk do të thotë që kur plotësohet ajo vlerë nuk mundemi me marrë prapë, jo 5 mijë, mundemi sa kemi nevojë mbase ta arsyetojmë 1 mijë euron e parë, së 1 mijë euro i kemi ndarë për shëndetësinë mundemi me plotësuar me e mbyll dhe me e hapë tjetrën nuk është problem.

Izet Sadiki, drejtor tha se kanë pas rritje, por fatkeqësisht nuk e kemi të mbuluar çështjen e barnave dhe materialeve shpenzuese, ku 32% ka qenë vitin e kaluar dhe vazhdon me qenë. Ju e dini që kemi pas një projekt 48 mijë euro për 3 vite për barna, që ne është dashtë t'i shpenzojmë për 1 vit për arsye se 68% të vitit të kaluar barnat nga lista esenciale janë mbuluar nga buxheti i komunës, dhe e njëjta gjë edhe këtë vit. Ai falënderoi Kryetarin Rama dhe drejtoreshën për mirëkuptimin, ne e kemi ndarë sivjet një buxhet 200 mijë euro për barna shtesë, i cili nuk ka qenë i planifikuar, e që nuk e di a do të na mbulojë

nevojat deri në fund të vitit për shkak të kërkesave që ne mbi 70 % jemi duke i mbuluar vetë edhe pse ka pas premtime nga Ministria që në korrik ose në gusht do të rritet dhe stabilizohet furnizimi me barna dhe material shpenzues. Ai tha se Prishtina është në fazën e krijimit të institucioneve sekondare dhe sigurisht kjo ka bërë që buxheti me qenë mbi 200% vitin e ardhshëm i rritur dhe investimi në Spital të Prishtinës do t'ju kthehet në pozitivitet. Ai po ashtu tha se Prioritetizimi i Spitalit të Prishtinës do të jetë shumë impakt i mirë edhe për punën që e bëjnë kolegët tanë dhe stafi, për arsye se këtu nuk është qëllimi për t'i mbrojtur kolegët tanë, por qëllimi është që ne duke krijuar standarde evropiane rrisim cilësinë e shërbimeve, sepse duke e forcuar shëndetësinë e Prishtinës, e forcojmë shëndetësinë në nivel të vendit. Drejtor Sadiki tha se këto projekte që është duke i bërë qeverisja e Kryetarit Rama, në Prishtinë në fushën e shëndetësisë, janë të dukshme dhe e falënderoi publikisht për atë se ai e ka prioritetizuar shëndetësinë dhe kjo po duket pas 1 viti e gjysmë të qeverisjes së tij.

Osman Bllaca, kryesues falënderoi të gjithë për pjesëmarrjen, duke e përmbyllur debatin.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Dëgjim publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024;

12.07.2023

Ora 14:00

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Gjinia	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	Besim	Mungeli				
2	Dilou	Ullomina				
3	Agnesa	Sahiti				
4	HANA	DESHKISHKY				
5	ZELFIDE	VI SOKU				
6	TEUTA	RUGOVA				
7	VEJERA	MAXHUNI				
8	BESA	CANHASI				
9	Violeta	Haxhiaj - Nohrdani				
10	Filipota	Stolac				
<p>P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera! *Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!*</p>						

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	Gjinia	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	Albi Dergut					
12	Shpresa Krasniqi					
13	Vjollca Feyzi					
14	Mirinda Hajdari					
15	Eriza Qorri					
16	Kiridon Gashani					
17	Zjaven Mahmuti/Kidoni					
18	Leart	Sevdin				
19	DARRAN	SRADIM				
20	Adriana	Mokalli				
21	Leona	Jashari				
22	KIMETE JASHARI					
23						
24						
25						
26						
27						
28						
<p>P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!</p> <p>*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!*</p>						

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	Gjinia	e-mail	Nënshkrimi/Signature
29	SINARIE	MEHMETI				
30	FUSANA	LUKAS				
31	PREKA S	HALIL				
32	FROJDE	HIGJENI				
33						
34						
35						